Thirrje për aplikim për grante

Për: Organizatat studentore dhe grupet joformale

Data e publikimit: 1 mars 2021

Afati i fundit për aplikim për organizata studentore është deri më 1 prill 2021. Për grupet joformale thirrja mbetet e hapur dhe aplikacionet do të pranohen në vazhdimësi.

Periudha e zbatimit të aktiviteteve për organizatat studentore: 1 maj 2021 – 30 qershor 2021.

Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim – ORCA, u bënë thirrje organizatave studentore dhe grupeve joformale studentore në Kosovë që të aplikojnë për skemën e granteve, me projekt-propozime, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë.

Rreth ORCA-s dhe fushëveprimit të saj

ORCA ka si mision kontributin për rritjen e cilësisë së arsimit në Kosovë, me fokus kryesor arsimin universitar. Mbikëqyr proceset akademike në arsimin e lartë si dhe angazhohet për rigjallërimin e aktivizmit studentor të sistemit publik universitar, përmes bashkëpunimit me organizatat dhe grupet joformale studentore.

Fushat e financimit

Skema e granteve e dizajnuar nga ORCA, si partner i projektit "Cilësi, llogaridhënie, integritet dhe transparencë në arsimin e lartë (QAINT)", i zbatuar nga konzorciumi KEC - ORCA – ZSI, do të mbulojë arsimin e lartë publik në Kosovë.

Do të merren parasysh projekt-propozimet, të cilat përqendrohen në nxitjen e aktivizimit të grupeve studentore për njohjen dhe adresimin e problemeve dhe çështjeve me rëndësi për interesin publik në arsimin e lartë.

Skema e granteve do të përqendrohet në ato projekte, të cilat si pikësynim kanë adresimin apo zhvillimin e aktiviteteve të caktuara që përfshijnë:

1. Integritetin akademik në universitetet publike;
2. Transparencën financiare të universiteteve publike;
3. Aktivitetet me rëndësi për zhvillimin e jetës studentore: aktivitetet kulturore, artistike, sociale dhe sportive, të cilat ndikojnë në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit;
4. Aktivitetet për nxitjen e vetëdijes kritike studentore;
5. Nismat për adresimin e problemeve të caktuara në kuadër të jetës universitare;
6. Aktivitetet për adresimin e formave të ndryshme të diskriminimit dhe të ruajtjes së ambientit;

7. Monitorimin e mbarëvajtjes së procesit studimor në distancë

Kush duhet të jenë përfitues të zbatimit të projektit?

Përfitues të zbatimit të projektit duhet të jenë: studentët, stafi akademik, fakultetet, departamentet, qendrat apo institutet e universiteteve publike.

Çka mund të jetë subjekt i financimit?

Të gjitha shpenzimet që lidhen me kryerjen e aktiviteteve sipas fushave të përcaktuara në këtë thirrje si:

- Hapësirat për kryerjen e aktiviteteve;
- Printimi i materialeve për zbatimin e aktiviteteve;
- Transporti;
- Shpenzimet e komunikimit;
- Shpenzimet për pajisje apo rekuizita të domosdoshme për zbatimin e aktiviteteve;
- Materialet shpenzuese apo promovuese për zbatimin e aktiviteteve

*Për të gjitha shpenzimet e lejuara, zbatuesit e projekteve duhet të jenë në gjendje të sjellin dëshmi të shpenzimeve dhe të aktiviteteve të kryera (fatura, kontrata, lista të pjesëmarrjes, fotografi, video, etj.)

**Për organizatat studentore të gjitha aktivitetet dhe pagesat duhet të kryhen brenda periudhës së zbatimit të përcaktuar në këtë thirrje (1 maj 2021 – 30 qershor 2021). Ndërsa për grupet joformale, aktivitetet dhe pagesat duhet të kryhen brenda një periudhe dymujore të çfarëdoshme.

Çka *nuk* mund të jetë subjekt i financimit?

- Pagat për zbatuesit e projektit (përveç shërbimeve të caktuara si: dizajni, video animacionet, përkthimi apo të ngjashme);
- Aktivitetet komerciale;
- Bursat;
- Aktivitetet e bamirësisë;
- Pajisjet elektronike (përveç në rastet kur arsyetohen si të domosdoshme për kryerjen e aktivitetit. Në këto raste pronësia fundore e pajisjeve do t'i takojë organizatës grantdhënëse apo përfituesit të zbatimit të aktivitetit sipas marrëveshjes paraprake)

Masat për mbrojtje nga COVID - 19

Të gjitha aktivitetet duhet të organizohen ashtu që të respektohen të gjitha masat e vendosura nga Ministria e Shëndetësisë, si dhe rekomandimet nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për mbrojtje nga COVID - 19.

Llojet e granteve

Thirrja e hapur për organizatat studentore dhe grupet joformale përfshinë grantet sipas kategorive:

- Për organizata të përfaqësuara në Parlamentet Studentore të universiteteve publike, grante në vlerë deri në 3,000 €;

- Për organizata të përfaqësuara në Unionin e Studentëve të Kosovës, grante në vlerë deri në 2,000 €;

- Për grupe joformale studentore të universiteteve publike, grante në vlerë deri në 1500 €.

Mënyra e aplikimit

Organizatat dhe grupet joformale studentore që aplikojnë për grantet e shpallura, duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- Formularin për aplikim, të plotësuar dhe të nënshkruar;
- Certifikatën e regjistrimit të organizatës (nëse është e aplikueshme);
- Statutin e organizatës (nëse është e aplikueshme);
- Buxhetin e projektit (i cili gjendet në formularin e aplikimit)

Organizatat studentore duhet t'i dorëzojnë Aplikimet/Dokumentet në liridona.orca@gmail.com, më së lagu deri më datë 1 prill 2021, në orën 15:00. Për grupet joformale nuk ka afat për dorëzimin e aplikimeve, pra do të pranohen në vazhdimësi.

Këto grante ofrohen në përputhshmëri të plotë me standardet shoqërore dhe mjedisore të projektit QAINT. Përparësi do të kenë aplikimet nga grupe dhe organizata studentore që angazhohen rreth çështjeve të barazisë shoqërore dhe atyre mjedisore e që ndërlidhen me interesin e përgjithshëm publik në arsimin e lartë, përfshirë këtu çështje gjinore, të minoriteteve, personave me aftësi të veçanta, etj. Në veçanti, inkurajohen që të aplikojnë organizata dhe grupe studentore me pjesëmarrje të barabartë gjinore në radhët e tyre.

Për paqartësi apo informata shtesë lidhur me thirrjen, mund t'i drejtoheni personit kontaktues - Liridona Ademaj, në e-mailin: liridona.orca@gmail.com.

WITH FUNDING FROM
AUSTRIAN DEVELOPMENT COOPERATION

KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center
ORCA organizata për rritjen e cilësisë në arsim
ZENTRUM FÜR SOZIALE INNOVATION CENTRE FOR SOCIAL INNOVATION ZSI